

**SHKOLLAT E MESME ARTISTIKE, SPORTIVE, GJUHËVE TË
HUAJA, ME KOHË TË SHKURTUAR**

Kjo është një skemë qortimi, në të cilën jepen **disa orientime** lidhur me vlerësimin e përgjigjeve të nxënësit.

- Testi përbëhet nga dy pjesë: një në poezi dhe një në prozë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 21 kërkesa.

Në vlerësimin e esesë duhet pasur parasysh:

- Përgjigja e nxënësit duhet vlerësuar në tërësinë e saj, për cilësinë që paraqet, për ndjeshmërinë, mendimin, idetë që ka shprehur dhe origjinalitetin e tyre.

Nxënësit që kanë probleme në drejtshkrim, por arrijnë të komunikojnë me shkrim një të kuptuar të qartë të pjesës letrare (të tekstit të dhënë) dhe të kërkesës, do të marrin pikët e plota për të kuptuarit. Nga ana tjetër, nxënësit që shkruajnë qartë, rrjedhshëm dhe pa gabime, por nuk dëshmojnë ndonjë të kuptuar të mirë të tekstit dhe kërkesës, do të marrin pikë për mënyrën e shprehjes, stilin dhe saktësinë drejtshkimore, por nuk do të vlerësohen për të kuptuarin. **Mos harroni**, se ky është një provim që vlerëson **aftësitë letrare** (përgjigjen letrare) dhe **jo aftësitë gjuhësore**.

- Gabime që nuk ndikojnë në cilësinë e përgjithshme të përgjigjes, nuk do të merren në konsideratë në vlerësim. Do të hiqen pikë vetëm për ato gabime që ndikojnë mbi cilësinë dhe që i gjykoni si të rënda.

PJESA I

EPOSI I KRESHNIKËVE - Martesa e Halilit

Kërkesat 1-5

| | | |
|------------------|----------|---------------|
| Kërkesa 1 | C | 1 pikë |
| Kërkesa 2 | C | 1 pikë |
| Kërkesa 3 | C | 1 pikë |
| Kërkesa 4 | B | 1 pikë |
| Kërkesa 5 | A | 1 pikë |

Kërkesa 6 2 pikë

- 1 pikë** Punët e malësisë, vajzat kullotin bagëtinë.
Kanë ra vashat me gja në lumë,
- 1 pikë** Normë zakoni i besës, betimi, mallkimi. *At be n'Zotin djali paska ba, "Dheu m'ka mblue e fat s'i qita vedit,/ po s'e mora Tanushën e Krajlit".*
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Kërkesa 7 2 pikë

- 1 pikë** Vargu është paradoksal, sepse pohon dy dukuri që kundërshtojnë njëra-tjetrën: *dielli ndriçon fort, por nxeh pak*, kur, duke ndriçuar fort, duhet të ngrohë më shumë.
- 1 pikë** Efekti që krijon është ai i magjisë e madhësisë së natyrës, ku përplasen kontraste të fuqishme që parathënë zhvillimin e një aksioni po kaq madhështor dhe të jashtëzakonshëm, si natyra alpine.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Kërkesa 8 5 pikë

Model përgjigjeje

Personifikimet, hiperbolat (*Ç'po merr fryma rrapin e Jutbinës/ Borë e madhe që ka ra...*), **epanastrofeja** dhe **aliteracioni** (*ushtojnë lugjet prej orteqesh, prej orteqesh kah po bijnë ndër gropa*), **inversioni, antiteza** (*fort po shndrit/ pak po nxe*), **anafora** (*kanë...kanë*), japin një konceptim hiperbolik të natyrës. Pyjet nga sasia e madhe e borës janë fundosur krejt, pishave u duken vetëm kreshtat, është aq ftohtë sa dhe *“krojet janë ngri hej”*, ushtojnë orteqet, stuhia ngre mjegull pjalmin e borës...

Raporti që krijohet:

Natyra është madhështore, e jashtëzakonshme, si e tillë ajo përputhet me bëmat e jashtëzakonshme të kreshnikëve. Tërë portreti dhe figura e tyre në tërësi merr kuptim brenda një natyre të tillë.

2 pikë Nëse gjen dy mjete të stilistikës

2 pikë Nëse shpjegon dy mjetet e stilistikës në funksion të fragmentit dhe tregon saktësisht imazhin që ato krijojnë.

1 pikë Nëse shpjegon raportin midis natyrës dhe kreshnikëve.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe nëse interpretimi që ka bërë nuk i përmbahet modelit të përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë.

Kërkesa 9 2 pikë

1 pikë Pyetja retorike: *Ç'ka e ka ba lumi ata t'bardhë?*

1 pikë Arsyeja është për të tërhequr vëmendjen (tani do ndodhë diçka e rëndësishme ose e çuditshme).

Për të mbajtur gjallë interesin e lexuesit dhe për ta bërë atë bashkëbisedues duke i dhënë komunikimit trajtën e stilit bisedimor.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Kërkesa 10 4 pikë

1 pikë Mënyra se si vjen pranvera është fantastike, sepse vjen menjëherë pas mallkimit të Halilit (*Po n'qafë m'paçi, mori Bjeshkët e Nalta,/ Sa mirë nama bjeshkët m'i paska gjue,*)

Matura Shtetërore 2007, Teste

- 1 pikë** Përshkrimi i ardhjes së saj, si dukuri fizike, është real, sepse: *deti ka çue një frymë të fortë,...të nxehtë,...të zezë...n'lumë.*
- 1 pikë** Shkrija është bërë me qëllim nga rapsodi, sepse nga njëra anë zgjon e rrit fantazinë e dëgjuesit përmes dukurish natyrore të jashtëzakonshme dhe nga ana tjetër i bën ato të besueshme përmes detajeve reale, për t'i përqsaur me bëmat e kreshnikëve.
- 1 pikë** Nga shkrija e reales me fantastiken përftohen **personifikime** befasuese; animizohen dukuri të natyrës: deti dëgjon, deti çon frymë (erë), bora ka ra në lumë (jo derdhur), *T'bardh...e ka mbyt (jo derdhur)*
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe nëse interpretimi që ka bërë nuk i përmbahet modelit të përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë.

PJESA II

FLOBER – Zonja Bovari

| | | |
|------------|---|--------|
| Kërkesa 11 | A | 1 pikë |
| Kërkesa 12 | B | 1 pikë |
| Kërkesa 13 | A | 1 pikë |
| Kërkesa 14 | C | 1 pikë |
| Kërkesa 15 | A | 1 pikë |

Kërkesa 16 3 pikë

- 1 pikë** Nëse formulon një fjali që shpreh thelbin e pjesës së parë. P.sh:
Ema e ëndërron jetën sipas modeleve të librave romantikë.
- 1 pikë** Nëse formulon një fjali që shpreh thelbin e pjesës së dytë. P.sh:
Ema ndjen zbrazëtinë e jetës bashkëshortore.
Ose
Ema e shikon sa e shkëputur është nga Sharli.
- 1 pikë** Nëse formulon një fjali që shpreh thelbin e pjesës së tretë. P.sh:
Sharli nuk përpiqet ta kuptojë.
Ose
Sharlit mjaftohet me atë lumturi që ka krijuar.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Do të pranohen si të sakta të gjitha formulimet e tjera që shprehin thelbin e secilës pjesë dhe që komisioni i vlerësimit i gjykon si të sakta.

Kërkesa 17 3 pikë

- 1 pikë** Ema ëndërron dhe fantazon një jetë si në libra. Detajet: *vende me emra kumbues, plogështi e këndshme, perde mëndafshi të kaltër, gurgullimën e shurdhët të ujëvarës, perëndon dielli, ngopesh me erën e limonave, kapur dorë për dore, vështron yjet, si bimë e veçantë, ballkon, vile zvicerane, shtëpizë fusharake skoceze, frak kadifeje të zezë, me kapelë me majë dhe me mansheta.*

Matura Shtetërore 2007, Teste

1 pikë Ajo ëndërron një burrë romantik, të ëmbël, që di gjithçka, që ta kuptojë, që të flasë me të. Detajet: *burri të veshur me frak kadifeje të zezë, burri të shkëlqejë në shumë drejtime, të njohë forcën e pashtershme të dashurisë, shijet e stërholluara të jetës, të gjitha të fshehtat.*

1 pikë Ema është romantike. Detajet na zbulojnë një natyrë që ka disa anë realiste por më shumë është romantike. Ema e përfytyron dashurinë, jetën dhe të shoqin sipas modeleve të librave romantikë.

1 pikë Ema do një jetë shpirtërore. Është qenie shumë e brishtë dhe delikate.

Personaliteti: Ema është naëve, e brishtë dhe shumë e thyeshme. Ëndërron shumë. Nuk është grua që i jepet vesit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Kërkesa 18 3 pikë

1 pikë Dy fjalët kyç që shprehin natyrën e marrëdhënieve janë:
lidhte - shkëputej.

1 pikë Figura që jep thelbin e kësaj marrëdhënieje është *antiteza*.

1 pikë Ema ka nevojë të ëndërrojë, pasi realiteti është shumë i zbrazët për të, i shoqi është shumë larg asaj ç'ka menduar ajo dikur. Ajo nuk gjen tek ai atë çfarë deshi, ndaj këtë kërkesë shpirtërore e përmbush duke ëndërruar. Ema pret të gjejë te Sharli heroin romantik ose "princin e kaltër". Por ai është kaq i zakonshëm dhe "i rrafshët".

Ose

Duke ëndërruar ajo përmbush atë zbrazëti të shpirtërore, që nuk ia plotëson dot asgjë në ambientin ku jeton. Është një mundësi për t'u shkëputur nga mediokriteti i jetës provinciale.

0 pikë Nëse gjen gabim dy fjalët kyç dhe figurën.

Nëse interpretimi nuk i përgjigjet thelbit të kësaj figure.

Nëse nuk përgjigjet fare.

Kërkesa 19 3 pikë

Model përgjigjeje

Po. Kjo nënkuptohet përmes theksimit të kontrastit që ekziston midis dy personazheve: Ema vetëm ëndërron dhe Sharli as e di, as e ndjen këtë.

Ema duket në sytë e të shoqit e lumtur, në fakt nuk është e tillë. Midis tyre mungon komunikimi. Ema është e zhgënjyer nga jeta dhe Sharli, madje ka momente që e përçmon atë. Ajo ndihet e huaj në këtë lidhje.

3 pikë Nëse shpjegon në mënyrë **të plotë** dhe të saktë arsyet pse kjo lidhje do të përfundojë në mënyrë tragjike, duke theksuar kontrastin midis të dy personazheve, mungesën e komunikimit, zhgënjimin e Emës dhe ndjesinë e saj se është e huaj dhe e shkëputur në këtë lidhje.

2 pikë Nëse shpjegon në mënyrë **të pjesshme** arsyet pse kjo lidhje do të përfundojë në mënyrë tragjike si p.sh: nënvizon kontrastin midis dy personazheve, mungesën e komunikimit.

1 pikë Nëse shpjegon në mënyrë **të pamjaftueshme** arsyet pse kjo lidhje do të përfundojë në mënyrë tragjike si p.sh: nënvizon vetëm kontrastin midis dy personazheve ose nënvizon vetëm një arsye.

0 pikë Nëse arsyet e dhëna nuk shpjegojnë saktë thelbin të kësaj marrëdhënieje që përfundon në tragjedi ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë nëse jep shpjegime të tjera që nuk i përmbahet modelit të përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon si të sakta.

Kërkesa 20 3 pikë

Model përgjigjeje

Ironizon Emën: *Që ta shijonte nektarin e tyre, e mira ishte të kalonte nëpër ato vende me emra kumbues; të mbyllej bashkë me trishtimin e saj në ndonjë shtëpizë fusharake skoceze, si bashkëshorte e një burri të veshur me frak kadifeje të zezë me kinda të gjatë dhe me çizme prej lëkure të butë, me kapelë me majë dhe me mansheta, vështron yjet dhe bën plane për të ardhmen; dhe në to qarkullonin mendime dosido të njerëzve me veshje aq të zakonshme; nuk kishte qenë në gjendje t'i shpjegonte asaj një term të të hipurit në kalë; Mirëpo, a nuk është e domosdoshme vallë që burri të shkëlqejë në shumë drejtime, ta bëjë bashkëshorten të njohë forcën e pashtershme të dashurisë, shijet e stërholluara të jetës, të gjitha të fshehtat?*

Matura Shtetërore 2007, Teste

Ironizon Sharlin: *Bisedat që bënte Sharli ishin të rrafshta si trotuare rrugësh; s' ishte bërë asnjëherë kureshtar të shkonte të shihte ndonjë shfaqje në teatër me aktorë nga Parisi; ai s' e prishte fare terezinë, që s' dilte kurrë nga ajo plogështi e patrazuar, që e ndiente bile veten të lumtur prej saj.*

2 pikë Nëse gjen disa momente ku autori ironizon të dy bashkëshortët.

1 pikë Nëse gjen vetëm një moment ku shfaqet ironia.

1 pikë Ironia nuk shfaqet në fjalët e autorit, por nënkuptohet nga veprimet e personazheve. Kështu Floberi realizon atë që quhet distancë objektive nga personazhet dhe na lejon ne si lexues t' i shohim gjërat më qartë dhe më me vërtetësi.

Ose

Brenda parimeve të tij krijuese është objektivizmi dhe impersonalizmi.

Ose

Në ironinë për Emën ndeshim ironinë e Floberit (realist) me romantizmin e theksuar të Emës, si kundërvënie e realizmit me romantizmin, si rrymë në kushte të reja letrare.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim (detaje që nuk kanë lidhje) ose nuk përgjigjet fare.

Kërkesa 21 10 pikë

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: IDEJA DHE ARGUMENTIMI

3 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- e ka kuptuar qartë në pikëpamje përmbajtjesore dhe artistike tekstin e dhënë (fragmentin)
- përcakton teknikat e përdorura nga autori për të arritur efekte të caktuara artistike
- interpreton në mënyrë analitike pjesën
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga teksti i dhënë
- përdor detaje mbështetëse
- ka qartësi mendimi

KRITERI II: STRUKTURA E ESESË

1 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- respekton elementet e strukturës së esesë:
hyrjen
zhvillimin
përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

Nëse mungon njëra prej tyre, ai do të marrë 0 pikë për këtë rubrikë.

KRITERI III: PASURIA GJUHËSORE

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shprehet me një gjuhë eseistike
- ka fjalor të pasur
- stil origjinal
- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore dhe fjalëformimi

KRITERI IV: LARMIA SINTAKSORE

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- zotëron sintaksën
- ka aftësi për të ndërtuar fjali që janë të sakta
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm
- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja sintaksore

KRITERI V: SAKTËSIA DREJTSHKRIMORE

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- ka saktësi drejtshkrimore
- përdor si duhet shkronjën e madhe
- përdor si duhet shenjat e pikësimit